

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2024**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2024.

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar në mungesën e likuiditetit të sistemit bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹) Burimi: Banka e Shqipërisë.

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj	REPO Njëditore		Totali i likuiditetit të injektuar
4-prill-24		29.97				29.97
11-prill-24		25.13				25.13
18-prill-24		37.57				37.57
24-prill-24			2.70			40.27
25-maj-24		39.45				42.15
02-maj-24		45.54				48.24
09-maj-24		43.20				45.90
16-maj-24		53.45				56.15
24-maj-24		48.49	9.05			60.24
31-maj-24		30.47				42.22
06-qershor-24		27.63				39.38
13-qershor-24		38.57				50.32
20-qershor-24		39.01				50.77
24-qershor-24			3.57			54.33
27-qershor-24		43.74				59.06

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë është rritur në mesatarisht 44.55 miliardë lekë nga 22.70 miliardë lekë që rezultonte në tremujorin e parë, dhe 45.40 miliardë lekë në të njëjtën periudhë të vitit 2023. Akumulimi i likuiditetit në llogarinë e

¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti.


MF ka qenë faktori kryesor i rritjes së mungesës së likuiditetit me një efekt neto mesatar rreth 40 miliardë lekë pasuar nga rritja e parasë në qarkullim, e përqendruar vetëm në muajin qershor me afërsisht 7 miliardë lekë.

Ndërhyrjet në tregun valutor kanë rritur likuiditetin e bankave me 22.56 miliardë lekë me një përqendrim më të madh në periudhën maj-qershor kur Banka e Shqipërisë, krahas blerjeve me ankand, ka nisur edhe ndërhyrjet në tregun valutor duke blerë valutë në përmbushje të objektivave të politikës monetare ose të stabilitetit financiar.

Gjatë periudhës në fjalë, sistemi bankar ka ulur përdorimin e depozitës prej niveleve të larta 12 miliardë lekë në fillim të periudhës deri në pothuaj 0 lekë në fund të saj.

Mungesa e likuiditetit ka shënuar nivelin e ulët 25 miliardë lekë në fillim të muajit prill dhe nivelin maksimal afërsisht 60 miliardë lekë në fund të muajit maj. Gjatë muajit qershor, mungesa është stabilizuar në 40-60 miliardë lekë, pasi efekti i akumulimit të likuiditetit në llogarinë e qeverisë dhe rritja e parasë në qarkullim janë neutralizuar nga efekti i ndërhyrjeve në tregun valutor.


Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2024 (me vlerë nominale)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke parë rritjen e mungesës së likuiditetit i cili arriti në nivelin mbi 40 miliardë lekë, Banka e Shqipërisë rifilloi injektimin e likuiditetit me afat tremujor, por duke synuar një peshë më të ulët se zakonisht, pa tejkaluar nivelin prej 30% me qëllim mbajtjen e peshës së injektimeve javore mbi 50% edhe në skenarin e rritjes së shpenzimeve nga MF.

Grafik 2: Normat e injektimit javor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme

Me rritjen e mungesës së likuiditetit, përdorimi i instrumentit të depozitës ka rënë në 3.75 mld lekë krahasuar me 18.90 mld lekë në tremujorin e mëparshëm.


Instrumenti i kredisë është përdorur në 12 raste, duke qëndruar në nivelet mesatare të vitit të fundit.

1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e Bankës së Shqipërisë

Gjatë 3-mujorit dytë të vitit 2024, Banka e Shqipërisë ka vijuar të tentojë rritjen e portofolit nëpërmjet ankandeve të blerjes së letrave me vlerë. Sikurse përgjatë gjithë vitit 2023, pjesëmarrja e bankave ka qenë mjaft e ulët. Përfshirja në blerje edhe e obligacioneve me maturim deri në 12 muaj krahas bonove të thesarit, ka bërë që pjesëmarrja të ketë përmirësim të lehtë në dy raste. Gjatë tremujorit janë maturuar 0.93 mld lekë bono thesari dhe janë blerë 1.26 mld lekë emetime të MF, 0.46 mld lekë prej të cilave kanë qenë obligacione me maturim deri në 12 muaj.

Vlera e portofolit të bonove të thesarit të Bankës së Shqipërisë është 70.00 miliardë lekë, pranë niveleve maksimale të vërejtura, ndërkohë që në terma relativë kundrejt borxhit publik të emetuar në monedhën kombëtare, madhësia e portofolit është nën 10% kundrejt rreth 25% në fillim të viteve 2000.

Grafik 3: Portofoli i Bankës së Shqipërisë (mld lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës, nuk janë zhvilluar operacione rregulluese.

2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2024


2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2024, sikurse lajmëruar në dhjetor 2023, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar shtatë ankande për blerjen e valutës, ku në përputhje me objektivin e zhvillimit të tregut, tre prej tyre ka qenë me optionin FORWARD.

Në ankandet e zhvilluara janë blerë 101.60 milionë euro pas blerjes prej 32.60 milionë eurosh në tremujorin e kaluar. Mesatarja e blerë në ankandet e këtij tremujori ka qenë 14.50 milionë euro.

Krahas blerjeve me ankand, prej datës 2 maj 2024, Banka e Shqipërisë ka filluar edhe ndërhyrjet në tregun valutor në përmbushje të objektivave të politikës monetare ose të stabilitetit financiar, nëpërmjet blerjes së 137.60 milionë eurosh.

Grafik 4: Ankandet e valutës.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kalendari i ndërhyrjeve			
Viti 2024			
	Data	Shuma Raundi I (në euro)	
1	16/02/2024	5-10 mln	1 mo Fw
2	15/03/2024	5-10 mln	
3	26/03/2024	5-10 mln	1 mo Fw
4	19/04/2024	5-10 mln	
5	30/04/2024	5-10 mln	1 mo Fw
6	17/05/2024	5-10 mln	
7	24/05/2024	5-10 mln	1 mo Fw
8	06/06/2024	5-10 mln	
9	13/06/2024	5-10 mln	1 mo Fw
10	21/06/2024	5-10 mln	
11	12/07/2024	5-10 mln	
12	19/07/2024	5-10 mln	
13	26/07/2024	5-10 mln	
14	09/08/2024	5-10 mln	
15	16/08/2024	5-10 mln	1 mo Fw
16	17/09/2024	5-10 mln	1 mo Fw
17	18/10/2024	5-10 mln	1 mo Fw
18	20/11/2024	5-10 mln	1 mo Fw
19	05/12/2024	5-10 mln	
20	20/12/2024	5-10 mln	1 mo Fw

** Ne rastet kur ankandi bie në ditë pushimi, ankandi do të organizohet në ditën pasardhëse të punës.*

Gjatë vitit 2024, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon të blejë përmes ankandeve shumën prej 250-330 milionë eurosh.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, MF ka maturuar shumën e plotë të marrëveshjeve SWAP me Bankën e Shqipërisë për shumën 24.90 miliardë lekë. Në veprime të tjera, janë blerë 1.2 milionë euro nga MFE të fondeve të programit IPA dhe shitur për ASD 0.50 milionë euro.